

“REVISTA E SHKOLLËS “Gj. K. Skenderbeu”

SHKOLLA JONË

Arsimi në shkollën tonë

Titujt kryesor

- Zemra e njerëzve të thyer
- Perandoria osmane
- Më të rejtat nga teknologjia
- The Lion and the Mouse
- Sëmundjet e trashëgueshme- Kanceri
- Vetitë negative të njeriut - duhani
- Çudira nga bota
- Bekim Fehmiu
- Agron Llakaj
- Barcoleta
- Kampionati botëror




The collage contains the following article titles and descriptions:

- ZEMRA E NJERËZVE TË THYER**: Article about heart health and emotional well-being.
- Perandoria Osmane**: Historical article about the Ottoman Empire.
- Më të rejtat nga teknologjia**: Article about modern technology.
- The Lion and the Mouse**: A fable about a lion and a mouse.
- Agron Llakaj**: Profile of the footballer Agron Llakaj.
- SËMUNDJET E TRASHËGUESHME- KANCERI**: Medical article about hereditary diseases and cancer.
- VETITË NEGATIVE TË NJERIUT - DUHANI**: Article about the negative effects of smoking.
- Çudira nga bota**: Article about interesting facts from around the world.
- Bekim Fehmiu**: Profile of the footballer Bekim Fehmiu.
- Kampionati botëror**: Article about the FIFA World Cup.

ZEMRA E NJERËZVE TË THYER

Zemra e njerëzve të thyer është në mungesë të dashurisë, të ngrohtësisë, të respektit për ta, për dritën e diellit e cila për ta nuk lind asnjëherë sepse janë në mungesë të pasurisë. Kemi shumë njerëz sot rrugëvetë cilët qëndrojnë pa strehë, pa ushqim, jetim nëna dhe babai e kanë lënë rrugëve të lypit, me të vërtetë diçka shumë e vuajtur nga shoqëria e sotme. Por kjo varfëri, këto vuajtje vijnë nga vetë ata përshakë se ata kur duheshin të mësojnë ata rrinin nuk mësonin dhe sot prandaj kanë ardhur në kaq nivel të ulët. Pse familja ime ose familja e juaj nuk ka rënë këtë nivel përshkakë se paraardhësit tona janë munduar të arsimohen edhe pse nuk kanë qenë në kushte të mira siç jemi ne sot, prindrit tona kanë ndëjtur aq larg atëdheut larg nesh për të punuar, për të fituar para që ne të mos biemë në varfëri, në vuajtje, po ne fëmijët çka bëjmë, I hedhim poshtë të gjithë të mirat dhe duam të bëhemi si shoqëria e varfër. Por unë di vetëm një gjë që e kemi shumë gabim, se ne kështu I hedhim të gjithë familje, prindër të gjithë dhe rrimë të pa arsimuar. Ne duhet të mbledhim forcat tona të fillojmë të arsimohemi, se nuk shkon kështu o shokë.



“Mjaftë më vuajtjeve, mjaftë varfërive, të arsimohemi të bëhemi njerëz të pasurë dhe të ditur!”

Ardit Elezi

Perandoria Osmane

Perandoria Osmane (1299 - 1923), është shteti paraardhës i Republikës së Turqisë së sotme dhe një nga perandoritë më të mëdha të historisë.

Përfshinte 22,9 milion km² në majë të lulëzimit në shekullin XVI duke mbajtur të pushtuara viset nga Afrika Veriore, Lindja e Afërt, Kaukazi deri në Evropë. Ishte rivali kryesor i shteteve evropiane kundër të cilave ndërmori shumë fushata ushtarake. Brenda perandorisë mbizotëronte rendi ushtarak dhe aristokracia e zgjedhur e padishahut ose sulltanit, sovranit të shtetit.

Shekujt XVI dhe XVII ishin kulmi i lulëzimit të kësaj perandorie, ndërsa në shekujt XVIII dhe XIX luftërat e shpeshta me Rusinë dhe Austro-Hungarinë shënojnë rënien. Përfshirja në Luftën e Parë Botërore, në krah me fuqitë qendrore, Austro-Hungarinë dhe Perandorinë Gjermane, osmanëve iu solli shkatërrimin e plotë të perandorisë së tyre. Lëvizjet nacionaliste turke shpallën Republikën e Turqisë në territorin e mbetur, i cili kryesisht banohej nga populli turk.

Rrethimi i Vijenës

Në vitet 70 të shek. XVII zhvilloi një luftë të gjatë me fundit u ndihmua nga Rudetyrja t'i lëshojë Polonisë torit të Ukrainës, kurse Rubregun e majtë të Luftën më të gjatë shteti me Austrinë. Lufta filloi në vitin 1683. Pretekst ishte përkrahja që i bëri Austria grupit

kundërosman. Ushtria osmane arrinte mbi 170 000 veta kurse ushtria austro-polake deri 63000 veta.

Duhet thënë se në ushtrinë osmane ishin marrë me forcë persona që nuk kishin kapur armë

me dorë: si shërbëtorë, zejtarë, tregtarë etj. Ushtria osmane me në krye sulltan Mehmetin IV dhe vezirin e madh, Kara Mustafa pashën, hynë në territoret hungareze që ndodheshin nën Austrinë. Sulltani synonte të merrte Vjenën.



shteti osman Poloninë. Kjo e sia. Sulltani u afro 2/3 e terrsisë Kievin e Ukrainës.

osman e zhvilloi

Më të rejat nga teknologjia

Super-kompjuteri

Është parashikuar se më vitin 2012 Kompania japoneze "Riken" do të fillojë prodhimin e një super-kompjuteri. Emri i të cilit nuk është bërë akoma i ditur.

I cili do të jetë 73 herë më i shpejt se super-kompjuteri i IBM "Blue Gene/L" që në ditët e sotme udhëheq klasifikim e 500 kompjuterëve më të shpejt në botë. Kompania japoneze "Riken" për prodhimin e këtij super kompjuteri duhet të shpenzoj 73 Milion

Euro.

Ky super-kompjuter do të jetë në gjendje të llogaris 10 Petaflop në sekond (10 milion trilion llogaritje në sekond).

Laptopi Adamo 13 më i hollë dhe më i lirë

Kompania "Dell" ulë çmimin dhe ia ngrit performansat e laptopit të tij ultra të hollë. Kompania "Dell" në laptopin e saj ultra të hollë Adamo 13 ka sjellë freski me harduer të ri dhe çmim më të ulët. Çmimi është ulur në 683 euro. Në këtë laptop ka mbetur vetëm shtëpiza nga alumini, ekrani 13.4 inçësh, bacteria prej gjashtë qelish si dhe modemi intern opsional 3G.

Kompjuteri tani vjen i pajisur me procesorin më të fuqishëm nga linja ekonomike Core 2 Duo SL9600 me takt pune 2.13 GHz, e i rifreskuari Adamo 13 në mënyrë standard me 4GB memori punuese, disk SSD me kapacitet 128 GB si dhe versionin 64 bitësh të sistemit operativ Windows 7.

Shkurtesa të dobishme për Windows

Tasti Windows + D – për të minimizuar të gjitha dritaret e hapura

Tasti Windows + E – hap Windows Explorer (jo Internet Explorer) për qasje më të shpejt në dosjen e diskut

Tasti Windows + F – hap dritaren për kërkim

Alt + Tab – kalimi nga një program i hapur në tjetrin.

Tasti Windows + Tab – kalimi nga një program i hapur në tjetrin në mënyrën *flip* (funksionon vetëm në Vista).

Alt + F4 – mbyll dritaren apo programin aktiv i cili është hapur aktualisht.

Ctrl+ESC – hap përzgjedhësin Start

Ctrl + C – Kopjon përmbajtjen e përzgjedhur.

Ctrl + X – Këput përmbajtjen e përzgjedhur.

Ctrl + V – Ngjit (anglisht. paste) përmbajtjen e kopjuar apo të këputur.



The Lion and the Mouse

Once when a lion was asleep, a little mouse began to run up and down his back. This made the lion wake up. With one swoop of his mighty paw, the lion pounced on the mouse and held her fast so she couldn't escape. Then he opened his mouth and was about to swallow the poor little creature.

The mouse spoke up. "O King", she said, "please forgive me for waking you. If you do, I will never forget it. And who knows? Maybe someday I will be able to do you a favor, too."

The lion thought this idea was so funny that he began to laugh and laugh. He lifted up his paw and let the mouse go.

Some time later, the lion found himself caught in a trap. The hunters wanted to take him to a zoo. They tied him to a tree while they went to get a wagon to carry him.

Just then, the little mouse happened to pass by. She took one look at the ropes and knew the lion was in trouble. So she went up to him and began to chew the ropes. Soon the lion was free.

"See," said the little mouse, "I was right!"



"Little friends may prove great friends."

SËMUNDEJET E TRASHËGUESHME-KANCERI

Sëmundjet e trashëguara, ose edhe kancerin. Kemi disa lloje sëmundjet gjenetike, janë të kancerve: sëmundje që transmetohen nga njëri brez në tjetrin. Sëmundjet gjenetike janë aktualisht të pashërueshme, mbasi shkenca akoma nuk është në gjendje të korrigojë defektin, edhe pse ekzistojnë



kura për to.

Në ndryshim nga sëmundjet e tjera, sëmundjet gjenetike, duke u transmetuar nga brezi në brez, përbëjnë një rrezik në rritje për popullatën, mbasi shtohen bartësit e fshehtë të këtyre sëmundjeve dhe, për rrjedhojë, rritet mundësia e lindjes së fëmijëve të sëmurë. Sëmundje trashëguese kemi

Kanceri i gjirit
Kanceri në stomak
Kanceri i lëkurës
Kanceri në mushkëri.

KANCERI I GJIRIT: Çdo vit kanceri i gjirit zbulohet i pranishëm në më shumë se 1 milion gra në botë dhe më shumë se 400 mijë gra vdesin çdo vit nga kjo sëmundje.

KANCERI I LËKURËS: Kanceri në lëkurë është një nga sëmundjet më të përhapura.


Shkaku kryesor, sipas shkencëtarëve, është ekspozimi i tepërt i lëkurës në



rrezet e diellit.

KANCERI NË STOMAK: Është një nga sëmundjet që po prek çdo ditë e më shumë njerëzit.

Sëmundja rritet me ritme të ndryshme dhe i



kundërpërgjigjet në mënyra të ndryshme mjekimit.

KANCERI NË MUSHKËRI: Kanceri i mushkërive është kanceri i dytë për nga shpeshtësia e përhapjes mes llojeve të kancerit dhe i pari për nga numri i vdekjeve. Në grafi kanceri shihet vetëm kur është mbi 1 cm, por kur kanceri i mushkërive ka arritur madhësinë 1 cm, zakonisht ka arritur të japë metastaza.

VETITË NEGATIVE TË NJERIUT- DUHANI

Njeriu në jetë posedon sjellje, edukatë, moral, mençuri dhe veti të tjera pozitive.

Por nga arsyet dhe situatat e ndryshme pa dëshirën e tij fiton edhe veti negative.

Një nga vetitë negative për njeriun është edhe pirja e duhanit. Duhani është shkakëtar kryesor i shumë smundjeve të ndryshme dhe vdekjeprurëse.



Nga pirja e duhanit njërëzit shkatërrojnë organet e frymemarrjes, zemrës dhe trurit. Paraqitet kanceri në mushkëri dhe me një fjalë njeriu nga pirja e

duhanit bëhet vrasës i vetëvetes. Vetitë tjetër negative e njeriut është pirja e alkoholit.

Alkooli të bën të ndjeshëm i cmendur dhe të tjerët të qeshin me sjelljen e tij.



Pirja e duhanit edhe me e demshme është për fëmijet, për të cilët rreptesisht ndalohet sepse përveç që ja shkatërron shëndetin, poashtu paraqet edhe sjellje të shëmtuar të tij.

Përveç vetive të përmendura, si vetitë negative e njeriut është edhe gënjeshtria, vjedhja dhe tradhëtia.

Konsiderohet se në botë ka mbi 1 miliard e 500 milionë përrës duhanit dhe raporti i vdekjeve të atyre që pinë duhan, kundrejt atyre që nuk pinë është 10 herë më i madh.



Unë u bëj apel të gjithë moshatarëve të mi dhe të gjithë njerëzve në përgjithësi që tu largohen vetive negative, dhe gjithmonë të posedojnë vetëm me veti pozitive. Vetitë negative na mashtrjnë, na turpërojnë dhe na dëmtojnë, kurse vetitë pozitive na stimulojnë, na bëjnë të ndihemi kërenar dhe të lumtur për të arriturat pozitive.

E PUNOI: Bleranda Lutfiju

Cudira nga bota

-Planeti Mars do të shfaqet në qiellin e natës në muajin Gusht te këtij viti.

-Do te jetë i dukshëm me sy të lirë po aq sa Hëna.

-Një pamje më të mirë do ta vini re me 27 Gusht ne orën 00:30, kur planeti Mars do të jetë në distance nga Toka vetëm 34.65M milie.

-Vini re qiellin e natës më datë 27 Gusht në orën 00:30.

-Do te duket sikur Toka ka dy Hëna

-MOS E HUMBISNI KETE RAST.... Hera tjetër që Marsi do të jetë pranë Tokës, do të jetë ne vitin 2287.



E punoi: Ardita Ballazhi

Bekim Fehmiu

Bekim Fehmiu ishte një aktor Shqiptar nga Kosova. Lindi në Sarajevë, Bosnja dhe Hercegovina më 1 qershor 1936 dhe vdiq më 15 qershor 2010 në Beograd, Serbia .

Rrjedh nga një familje e njohur gjakovare. Babai i tij, Ibrahim Fehmiu, ishte patriot i shquar, njëri ndër mësuesit e gjeneratës së parë në Kosovë dhe propa-



gandues i madh i arsimit në gjuhën shqipe.

Fehmiu u bë i famshëm me filmin "Mbledhësit e Pupleve", në vitin 1966. Deri në atë kohë, ai kishte studiuar dhe ishte bërë i njohur nga shumë shtëpi filmi nëpër botë. Ai është aktori i parë shqiptar i filmit dhe i teatrit, i cili ka luajtur me sukses në filmat dhe skenat e gjithë hapësirës së ish-Jugosllavisë. Ka qenë një nga personalitetet që ka lënë gjurmë në kinematografinë ballkanike, por mbi të

gjitha, ai është i madh për kontributin artistik në kinematografinë botërore.

E punoi: Hava Rrahmani

Agron Llakaj



AGRON LLAKAJ KA LINDUR NË QYTETIN MEMALIAJ TË RRETHIT TEPELENË, NË 24 PRILL 1960. STUDIMET E LARTA NË AKADEMINË E ARTEVE I KREU NË VITET 1987 - 1991. AKTIVIZIMET E TIJ KANË QËNË INTENSIVE SI I FTUAR SPECIAL NË PROGRAMET E "12 NË HOLLIVUD ", "12 VALLËZIME PA NJË TË SHTUNE " DHE "12 JAVË RRETH FATIT" ETJ. NË TRANSMETIMET E SPEKTAKLEVE TELEVIZIVE MË TË SHIKUARA SI AJO E "TELEBINGO", LLAKAJ KA QËNË PREZENT PREJ VITEVE 1996 -2002. AI KA BASHKËREALIZUAR

FILMIN "TITANIKU ME TV KLAN NË VITIN 1998 DHE AKTUALISHT ËSHTË DREJTOR ARTISTIK, PREZANTUES, MODERATOR DHE AKTOR I SPEKTAKËLIT TË HUMORIT PORTOKALLI ". NDERUAR NGA PRESIDENTI I REPUBLIKËS BAMIR TOPI, ME URDRIN "MJESHTËR I MADH".



E punoi: Hava Rrahmani

Barcoleta

Nastradini në pemë

Nastradini kishte hipur mbi
pemë dhe hante banana.
Aty kalojnë shokët e tij
dhe fillojnë ta ngacëmojnë.
E di Nastradin, se majmunët
kanë zbritur shumë kohë më pare
Po shoh – ua këtheu ai.

Nastradini në amerikë

Nastradini shkoi në Amerikë
dhe takoi një shoqe
Por Nastradini nuk dinte Anglishte
Shoqja e vetë i thotë:
What's up baby?
Ai thotë: Unë bebe te dukem
2 metra burrë

Nastradini gjumash

E shkundi një natë gruaja Nastradinin.
S'të vjen keq që kam tërë natën pa gjumë
duke tundur djalin që qanë?
Tunde edhe ti pak se fundja djali
nuk është vetëm i imi është edhe i yti.
Ti tunde tënden gjysmën time lëre të qajë .

E punoi: Peme Ballazhi

Edukimi i nxënësve

Në ditët e sotme në vendin tonë procesi i arsimit dhe i edukimit po shfaq një shturje apo dis-balancë nga procesi i zhvillimeve shoqërore-ekonomike brenda dhe jashtë vendit. Duke qenë të vetëdijshëm se edukimi është i pandarë nga shoqëria në të cilën ajo shoqëri zhvillohet, atëherë ne po flasim për edukimin e përgjithshëm të shoqërisë, në të cilën janë pjesëmarrës edhe të rinjtë (nxënësit), të cilët përmes shkollimit (edukimit) arrijnë të përvetësojnë njohuri dhe vlera që na përcjellin në gjatë tërë jetës. Por, është e qartë se një grupi shoqëror (e në këtë rast po aludojmë në edukimin e nxënësve), nuk mund t'i jepen kurrsesi të gjitha njohuritë, apo vlerat me të cilat mund të identifikohemi si shoqëri përparimtare, sepse edukimi nuk fillon vetëm me procesin e shkollimit. Duke e ditur se “agjenda primare” të jetës sociale të individit janë: familja, shkolla, moshatarët, masmediat; atëherë këtu duhet të theksojmë se edukimi i të rinjve (nxënësve) shtrihet në faza të ndryshme dhe

gjithashtu përcillet nga koordinimi i mirëfilltë dhe i vazhdueshëm i faktorëve që u përmenden më lartë. Çështjen e ddukimit të të rinjve (nxënësve) duhet trajtuar sipas rëndësisë dhe faktorëve kryesorë që e përcjellin atë, për shembull: dështimi shkollor; përshtatja e sistemit edukativo arsimor në kulturën e komunitetit shoqëror përkatës; gjuha e arsimit në procesin mësimor etj., etj.. Të fillojmë me trajtimin e parë të rëndësishëm “Dështimi shkollor”. Jemi dëshmitarë se në vendin tonë nuk




po arrihet dot një mesatare e kënaqshme apo një rezultat i mirë i nxënësve që po aftësohen për orientime profesionale të mëtutjeshme. Shtrohet pyetja: Përse të rinjtë (nxënësit) në vendin tonë dështojnë të kenë rezultate të mira dhe nuk po arrijnë aftësimin e duhur profesional dhe arsimor?

Problemi është sepse kemi një mangësi të madhe në trekëndëshin: Familja – Shkolla – Nxënësi, dhe anasjelltas!

Siç theksuam më herët, familja është një ndër

shtyllat më të rëndësishme në edukimin e individit, si pjesë e pandashme e shoqërisë, por gjithashtu jemi të vetëdijshëm se me të vërtetë po punohet pak me të rinjtë nga familjet tona. Ne nuk po u ndihmojmë atyre që së paku t'i orientojmë në rrugën e duhur, dhe mos t'i lemë pa identitet dhe vlera.

Është e vërtetë që në rrethanat tona është e vështirë t'u ofrojmë kushte për t'i arsimuar, ngase jemi në një gjendje ekonomiko-sociale jo të kënaqshme, mos të them “të mjerë”, por a duhen kushte të veçanta për t'u ndihmuar që së paku mos të ndihen të lënë pas dore? Pastaj, nuk duhet anashkaluar edhe mos koordinimin dhe papërgjegjësinë e institucioneve shkollore, që për mendimin tim, ka një pa kujdesi të madhe në frymën e trajtimit sa më adekuat të nxënësve në proceset mësimore. Qëllimi i institucionit shkollor duhet të jetë që, të rinjtë (nxënësit) të ndjehen pjesa më e rëndësishme e shoqërisë, ashtu siç edhe janë, e mos të ndjehen si “udhëtarë”, që rastësisht u gjenden në “stacion të panjohur”.



Kampionati botëror

Kampionati botërorë i futbollit është futbollë për kombëtare ky kampionat mbahet cdo 4 vjet.



Rregullat:

Per te marrë pjese ne këtë kampionat çdo kombetare i nenshtrohet nje kualifikimi kurse organizatori (shteti) kualifikohet direkt ne kualifikim bën pjesë çdo shtet i cili eshte i pranuar nga FIFA.

Botrori i parë u mbajt ne vitin 1930 ne Uruguaj ku fituesi ishte po vet uruguaj duke mundur Argjentinën me rezultat 4:2.

Botrori i fundit qe u mbajt ishte botrori ne Afriken e Jugut ku fitues ishte Spanja pas shum mundimesh. Ajo mundi ne finale Holanden me rezultat minimal 1:0 dhe u shpall kampion.

E punoi: Egzon Maksuti

SHKOLLA JONË



Humor

- Ilaçet i pi vetëm nga dora e gjyshit—thotë një fëmijë.
 - Përse? - pyet shoku i tij.
 - Sepse gjyshit i dridhet dora dhe i derdhet gjysma e ilaçit të hidhur—ia kthen fëmiu.

**“GJ. K. SKENDER-
BEU”**


Sërbicë

Komuna e Oslomesë

6254 Kerçovë

Tel: +389 45 258 821

Fax: +389 45 258 821



Udhëheqse e revistës:

- **Prof. Bukurije Ibrahim**

Perpiluan revistën:

- **Nxënësit e klases së VII**